



SKENIMI I KORRUPSIONIT

2016

SKENIMI I KORRUPSIONIT

2016

NËNTOR, 2016

Realizimi i këtij hulumtimi është përkrahur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë.

Mendimet e shprehura në këtë raport nuk i paraqesin medoemos pikëpamjet e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë.



Kingdom of the Netherlands

© Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara nga Lëvizja FOL. Të drejtat dhe prona intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Përmbajtja

Hyrje	5
I. Përmbledhje	7
II. Metodologjia	8
III. Gjetjet – Skanimi i Korrupsionit	11
1. Gjetjet nga Anketimi i Drejtëpërdrejtë	11
2. Gjetjet nga Intervistat	39
3. Gjetjet nga Shtatë Fokus Grupet	40
IV. Konkluzionet	44

HYRJE

Ky raport paraqet të gjetura mbi perceptimin publik ndaj korrupsionit në Kosovë. Të gjeturat e paraqitura këtu janë të bazuara në (1) rezultatet e anketës së drejtpërdrejtë me rreth 1,200 respondentë në të gjitha komunat e Kosovës; (2) intervistat e mbajtura me 26 përfaqësues të sektorëve të ndryshëm publik, privat, dhe jo-qeveritar; dhe (3) diskutimet nga shtatë fokus grupe të mbajtura në shtatë qendrat më të mëdha të Kosovës.

Pjesëmarrësit në këtë hulumtim janë pyetur, në mes tjerash, për perceptimet e tyre për korrupsion, përvojat me raste korruptive në institucione publike, pranueshmërinë e sjelljeve korruptive në institucionet publike, tendencën për të ofruar ryshfet apo dhurata për të kryer shërbimet e kërkuara, dhe gatishmërinë e tyre për të raportuar korrupsionin.

Kapitulli I prezanton një përmbledhje të të gjeturave kryesore. Në Kapitullin II lexuesi mund të gjej një përshkrim të metodologjisë që është përdorur për kryerjen e hulumtimit në terren. Kapitulli III përbëhet nga tre nënkapituj dhe prezanton gjetjet nga hulumtimi në terren, të ndara sipas metodave të hulumtimit (1) gjetjet nga anketimi; (2) gjetjet nga intervistat; (3) gjetjet nga fokus grupet. Në raste të caktuara, në pjesën për gjetjet nga anketimi, ka referim edhe në gjetje nga intervistat dhe fokus grupet për të bërë një ndërlidhje në mes perspektivave të ndryshme të hulumtimit. Në fund, Kapitulli IV bën një përmbledhje të gjetjeve për të analizuar ngjashmëritë dhe dallimet në mes këtyre tri perspektivave.

Lëvizja FOL dëshiron të falenderoj të gjithë pjesëmarrësit të cilët kanë ndarë kohën e tyre për t'u intervistuar dhe për të qenë pjesë e fokus grupeve dhe kështu kanë kontribuar në gjetjet e këtij hulumtimi. Rezultatet e prezantuara në këtë hulumtim janë të bazuara në përgjigjet dhe opinionet e tyre.

I. PËRMBLEDHJE

Ky raport paraqet të gjetura mbi perceptimin publik ndaj korrupsionit në Kosovë. Të gjeturat kryesore të këtij raporti, përfshirë anketimin në terren, intervistat, dhe fokus grupet janë të paraqitura në vijim:

- Rreth 58% e të anketuarve kanë identifikuar papunësinë si problemin më të madh të qytetarëve të Kosovës, përderisa korrupsioni ka qenë si kategoria e dytë më e përzgjedhur nga 15.5% e respondentëve;
- Përafërsisht 18% e të anketuarve raportuan korrupsionin si rrezik për familjet tyre, po aq përqindje e lartë raportuan edhe vjedhjet;
- Në aspektin e njohjes së korrupsionit, "ofrimi i parave Policisë me qëllim të parandalimit të dënimit", "pranimi i parave nga zyrtarët publik me qëllim të fshehjes apo zvogëlimit të tatimit", dhe "ushtrimi i presionit në votues nëpërmjet ofrimit të dhuratave në shkëmbim të votave", janë identifikuar nga 90% të anketuarve si sjellje të mundshme korruptive;
- Shumica e të anketuarve, në shumicën e situatave kanë raportuar një tolerancë të ultë ndaj korrupsionit. Nga dhjetë (10) situata të ndryshme mesatarja e atyre që thanë që korrupsioni është plotësisht i papranueshëm ishte rreth 87%, gjersa vetëm 3.3% e të anketuarve ishin të mendimit që korrupsioni është plotësisht i pranueshëm;
- Të pyetur nëse ishin të gatshëm të ofronin mito (ryshfet) ndonjë zyrtari për të zgjedhur një problem të madh në institucione publike, rreth 67% e të anketuarve raportuan që nuk do të bënin një gjë të tillë, gjersa 33% raportuan që do të mund të ofronin në situata të caktuara;
- Këto rezultate tregojnë që shumica absolute e qytetarëve kanë tolerancë të ultë ndaj korrupsionit, por në të njëjtën kohë nëse janë të detyruar që të ofrojnë mito (ryshfet) për të zgjedhur një problem të madh në institucionet publike një e treta e respondentëve raportuan që do të mund të ofronin mito (ryshfet).
- Të anketuarit mendojnë që në shumicën e institucioneve publike ekziston korrupsion i nivelit të lartë, kjo shifër kalon 50% për 12 entitete publike, gjersa vetëm për katër (4) institucione publike perceptimi që ka korrupsion në nivel shumë të lartë nuk kalon 50%;
- Ministritë konsiderohen si institucione me prezencë të korrupsionit në nivel shumë të lartë nga 71% e të anketuarve, pastaj zyra e kryeministrit 69%, dhe partitë politike 65%;
- Rreth 60% e të anketuarve raportuan që mendimet e tyre rreth korrupsionit i bazojnë në raportimet e mediave, 15% në bisedat me shokë, shoqe apo familjarë, 13% në përvojat e përjetuara personale, dhe 12% në përjetimet e të afërmeve të tyre;

-
- Rreth 63% e të anketuarve mendojnë që dëshira për pasurim të shpejtë është arsyeja e korrupsionit, e pasuar me 54% të respondentëve që mendojnë që shkak është mungesa e llogaridhënies qeveritare. Mosefikasiteti i sistemit gjyqësor shihet si shkak i korrupsionit nga ana e 35% të respondentëve;
 - Në përgjithësi, të intervistuarit pranojnë se korrupsioni në Kosovë është realitet, dhe jo vetëm perceptim. Të intervistuarit theksuan se korrupsioni është i përhapur në pothuajse të gjithë sektorët duke përfshirë ministritë, komunat, prokuroritë, gjykatat, dhe bizneset;
 - Disa prej të intervistuarve theksuan se qytetarët nuk janë të informuar se cilat veprime mund të konsiderohen si korruptive, dhe theksuan se nganjëherë qytetarët janë të gatshëm të paguajnë për shërbime pa pasur nevojë, për shembull për shërbime shëndetësore për shkak që korrupsioni është pranuar si normë;
 - Pjesëmarrësit në fokus grupe, ngjashëm me ata në intervista, ishin kryesisht të mendimit që korrupsioni në Kosovë është i përhapur në të gjitha institucionet dhe është pjesë e zingjirit institucional, dhe theksuan se korrupsioni është më i përhapur në institucionet shëndetësore;
 - Pjesëmarrësit në fokus grupe shprehën që hezitojnë apo frikësohen për të raportuar në rast se ata shohin apo hasin në ndonjë veprim korruptiv, për shkak që mund t'i humbasin mundësitë për punësim për të ardhmen, apo për shkak që prapa veprimeve korruptive ka figura të fuqishme politike.

II. METODOLOGJIA

Për të hulumtuar perceptimin publik mbi korrupsionin në Kosovë, janë përdorur tri metoda të hulumtimit (1) anketë e drejtpërdrejtë me një mostër prej afër 1,200 respondentëve përfaqësues për të gjithë popullatën e Kosovës, në rajonin e Prishtinës 296, Mitrovicës 183, Pejës 103, Prizrenit 208, Ferizajit 169, Gjilanit 119 dhe në rajonin e Gjakovës 98 respondentë; (2) intervista me 25 përfaqësues të sektorëve të ndryshëm publik, privat, dhe jo-qeveritar; dhe (3) shtatë fokus grupe në rajone të ndryshme në Kosovë.

Sa i përket anketimit, është përdorur metoda e anketimit personal të drejtpërdrejtë. Respondentët janë anketuar në shtëpitë e tyre me anë të tabletave. Popullata për këtë anketë është përcaktuar si një anketë për të gjithë të rriturit të moshës 18 vjeçare dhe më lartë që jetojnë në ekonomitë familjare në Republikën e Kosovës.

Për të siguruar që hulumtimi të jetë përfaqësues për gjithë popullatën e Kosovës, pyetësorët janë përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe. Për shkak të kufizimeve objektive pyetësori nuk është përkthyer në gjuhën rome, boshnjake dhe turke, por të dhënat mbi këto komunitete janë përdorur pyetësorët në gjuhën shqipe apo serbe ngase shumica e këtyre komuniteteve e di të paktën njërën nga këto gjuhë.

Për të përfunduar më një mostër përfaqësuese për popullatën është përdorur selektimi probabil i rastësishëm ku çdo anëtar i popullatës ka pasur gjasa të njëjta të jetë i kyçur në hulumtim.

Për selektimin e mostrës është përdorur metoda “probabile me shumë hapa”. Në mënyrë të veçantë, për këtë anketë është bërë selektimi duke shtresuar popullatën sipas rajoneve dhe zonës së banimit. Pastaj, gjatë përzgjedhjes janë bërë selektimet e vendnumërimeve në mënyrë të rastësishme nga hartat përkatëse të rajoneve dhe qyteteve (vendnumërimi ishte lagje në qytet apo fshat). Çdo vendnumërim ka pasur maksimum prej 10 të anketuarve. Më pas, është bërë përzgjedhja e ekonomive familjare përmes teknikës së rastësishme.

Si hap i fundit, ishte përzgjedhja e të intervistuarve në familje e cila është bërë në mënyrë të rastësishme nëpërmjet përzgjedhjes sipas muajit të lindjes. Individët brenda çdo familjeje janë përzgjedhur rastësisht për të marrë pjesë në anketë, duke përdorur muajin e ditëlindjes - d.m.th. çdo pyetësor ka pasur muajin e lindjes të shënuar ku intervistuesi pasi që ka marrë datat e lindjes së anëtarëve të familjes, pas regjistrimit, intervistuesi ka përzgjedhur personin me datën më të afërt të lindjes me muajin e shënuar në pyetësor. Personi me ditëlindjen më të afërt me datën 15 të muajit të parazgjedhur është selektuar për të marrë pjesë në anketë. Nëse individi i zgjedhur nuk ishte prezent në atë kohë, është caktuar një takim për intervistë për një datë të mëvonshme.

Së pari, në anketë të drejtëpërdrejtë kanë marrë pjesë 1 193 persona, 586 (49.1%) meshkuj dhe 607 femra (50.9%). Moshë ka variuar nga 18 vjeç në 85 vjeç, me një mesatare 40.5 vjeç dhe devijim standard 15.9, mosha mediane ka qenë 39 vjeç. Në aspektin etnik, 3.7% e mostrës nuk janë deklaruar apo nuk kanë qenë të shënuar në databazë, 86.5% janë deklaruar shqiptarë, 5.9% serbë, 4.1% pjesëtarë të etnive të tjera.

Së dyti, sa i përket intervistave, janë zhvilluar 25 intervista të thella me përfaqësues të mediave, institucioneve publike, bizneseve dhe organizatave jo-qeveritare. Me të intervistuarit janë diskutuar gjetjet paraprake nga anketimi dhe janë eksploruar çështje që kanë të bëjnë me sektorë të veçantë. Intervistat kanë qenë gjysmë të strukturura ku intervistuesi ka pasur pyetje orientuese dhe më pastaj ka përcjellur më shumë me pyetje inkurajuese dhe eksploruese për të kuptuar më hollësisht çështjet që ndërlidhen me korrupsionin kryesisht në sektore të caktuara apo edhe në përgjithësi. Intervistat e thella në metodologji janë shfrytëzuar për të eksploruar më në thellësi çështjet që ndërlidhen me korrupsionin në sektore të caktuara.


Së treti, sa i përket fokus grupeve, pjesëmarrësit janë ftuar (përzgjedhje e qëllimshme) nga koordinatori i projektit dhe është tentuar që në shtatë fokus grupe të përfshihen persona nga profileve të ndryshme socio-ekonomike. Fokus grupet janë mbajtur në shtatë rajone: Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjakovë, Pejë, Gjiilan dhe Mitrovicë. Fokus grupet janë kryer me moderator të dyfishtë. Kjo metodologji përdor dy moderatorë, njëri që lehtëson seancat ndërsa personi tjetër siguron që të gjitha temat e synuara janë të mbuluara dhe marrin përgjigje nga pjesëmarrësit. Në total në fokus grupe kanë marrë pjesë 50 pjesëmarrës nga të cilët 30 kanë qenë të gjinisë mashkullor dhe 20 kanë qenë të gjinisë femërore. Mosha e pjesëmarrësve ka variuar nga 19 deri në 71 vjeç. Fokus grupet kanë zgjatur mesatarisht nga 60 deri në 90 minuta.

Pjesëmarrësit në fokus grupe janë ftuar që të interpretojnë disa nga të gjeturat nga studimi kuantitativ dhe të diskutohet për të gjeturat, mendimet, qëndrimet dhe përvojat e tyre. Për çdo fokus grup është hartuar një raport i veçantë duke komentuar edhe të gjeturat nga fokus grupet e tjera. Për më tepër, të gjitha fokus grupet janë regjistruar dhe transkriptet e veçanta janë nxjerrë për çdo fokus grup.

III. GJETJET – SKENIMI I KORRUPSIONIT

1. GJETJET NGA ANKETIMI I DREJTËPËRDREJTË


Në këtë pjesë të raportit paraqiten grafikonet dhe interpretimet e gjetjeve nga anketimi i drejtëpërdrejtë i afër 1,200 respondentëve nga të gjitha komunat e Kosovës. Të pyetur se cili është “problemi më i madh që kanë qytetarët e Kosovës”, shumica e respondentëve apo rreth 58% e tyre kanë zgjedhur papunësinë si problemin kryesor, përderisa si kategoria e dytë më e përzgjedhur ishte korrupsioni me 15.5%, gjersa moszhvillimi ekonomik ishte kategoria e tretë me 11.5%.



Të pyetur për kërcënimet e sigurisë që ata i shohin si të rrezikshme për familjet e tyre, shumica e të anketuarve, nga rreziqet e ndryshme për familjet e tyre zgjedhën korrupsionin si kërcënim (rreth 18%), po aq përqindje e lartë konsiderojnë vjedhjet si rrezik për familjet e tyre. Vrasjet u raportuan si kërcënim nga 16% i respondentëve, plaçkitjet nga 12% dhe aksidentet e trafikut nga 10%. Rreth 2% raportuan që ndihen të kërcënuar nga sulmet e mundshme terroriste dhe rreth 1% nga ngritja e grupeve radikale.

Nga hulumtimet kualitative (fokus grupet dhe intervistat) rezultatet me lartë janë shpjeguar me faktin që në shumë raste korrupsioni ndikon në mirëqenien e qytetarëve. Si rrjedhojë nëse familja rrezikohet nga varfëria kjo është pasojë e korrupsionit apo në sektorin e shëndetësisë qytetarët ndjehen të rrezikuar nga korrupsioni, si në rastin e stendave.


Figura 2. Kërcënimet ndaj sigurisë familjare



Në aspektin gjinor, janë vërejtur dallime të vogla ndërmjet femrave dhe meshkujve sa i përket perceptimeve për kërcënimet ndaj familjes. Meshkujt si rrezik kryesor kanë parë korrupsionin, përderisa femrat vjedhjet. Përveç kësaj, femrat më shumë i shohin vrasjet si kërcënim në krahasim me meshkujt, sikurse edhe plaçkitjet dhe qentë endacak. Në anën tjetër, më shumë meshkuj shohin krimin e organizuar dhe aksidentet e trafikut si rrezik për sigurinë e familjes së tyre se sa femrat.

Ashtu siç është raportuar më lartë, respondentët korrupsionin e lidhin me problemet në shërbimet publike të cilat po ashtu mund të rrezikojnë të ardhurat e familjes por edhe gjendjen shëndetësore të tyre. Në këtë aspekt, korrupsioni më shumë është raportuar nga meshkujt, gjersa femrat si problem më të madh i shohin vjedhjet dhe vrasjet.


Figura 3. Kërcënimet ndaj sigurisë familjare sipas gjinisë së të anketuarëve



Vlen të theksohet se në pyetjen për kërcënimet ndaj familjes nuk ka pasur dallime të rëndësishme në përgjigje në aspektin e radhitjes së problemeve ndërmjet respondentëve nga fshatrat dhe atyre në qytete.


Për të matur njohuritë e qytetarëve lidhur me korrupsionin një listë e sjelljeve korruptive iu tregua të anketuarve dhe ata u pyetën nëse ata i konsiderojnë ato si sjellje korruptive. Nga katërmbëdhjetë sjellje të ndryshme, "ofrimi i parave Policisë me qëllim të parandalimit të dënimit", "pranimi i parave nga zyrtarët publik me qëllim të fshehjes apo zvogëlimit të tatimit", dhe "ushtrimi i presionit në votues nëpërmjet ofrimit të dhuratave në shkëmbim të votave", u vlerësuan si sjelljet më korruptive, nga më shumë se 90% e të anketuarve. Në anën tjetër "kopjimi gjatë provimit" u raportua si sjellje korruptive nga më së paku respondentë (vetëm 70% të tyre). Mesatarja e njohjes për 14 sjelljet korruptive ishte 84% që paraqet një përqindje të lartë të njohjes së sjelljeve korruptive.

Figura 4. Sjelljet që njihen si sjellje korruptive, tri më të lartat dhe tri më të ultat



Për të parë faktorët që ndikojnë në njohjen e korrupsionit, përgjigjet në pyetjet që kanë të bëjnë me sjelljet e ndryshme korruptive janë mbledhur dhe mesatarja e pikëve është kalkuluar për respondentë dhe sipas analizave nuk ka dallime në bazë të faktorëve demografik, përveç faktorit të moshës dhe të grupit etnik. Më specifikisht, niveli i njohjes së korrupsionit është kalkuluar duke marrë mesataren e përgjigjeve në 13 pyetjet lidhur me njohuritë e korrupsionit, në këtë aspekt sa më e lartë është mesatarja aq më e lartë është njohuria e korrupsionit. Sipas analizave, njohuria e korrupsionit nuk dallon sipas gjinisë, vendbanimit, rajonit, apo edukimit të respondentit. Në anën tjetër niveli i njohjes së korrupsionit ka dallime sipas moshës ku me rritjen e moshës rritet edhe niveli i njohurive për korrupsionin dhe sipas etnisë, ku niveli i njohjes së korrupsionit është më i ultë për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në krahasim me komunitetet tjera në Kosovë.

Figura 5. Njohja e korrupsionit




Në përgjithësi, sipas anketës dhe fokus grupeve njohja e sjelljeve korruptive është e lartë dhe shumica e qytetarëve sjelljet korruptive i klasifikojnë si të tilla. Por, në disa fokus grupe disa sjellje korruptive si përdorimi i lidhjeve për të përfunduar punë më shpejt në institucione, mospritja në rend në institucione, ofrimi i drekës apo darkës pas kryerjes së ndonjë pune institucionale, marrja e informatave nga të njofshëm për tenderët apo për vendet e punës nuk konsiderohen si sjellje korruptive nga shumë qytetarë të Kosovës dhe në shumë raste këto shihen si gjëra normale.

Për të matur tolerancën ndaj korrupsionit respondentëve iu tregua një listë me situata dhe institucione, dhe pastaj u pyetën nëse është e pranueshme apo e papranueshme që ata të japin para, dhuratë ose ndonjë shërbim për të zgjedhur problemet personale në institucionet e ndryshme publike. Sipas rezultateve shumica e repondentëve, në shumicën e situatave kanë deklaruar se korrupsioni është i papranueshëm, pra kanë treguar që kanë një tolerancë shumë të ulët ndaj korrupsionit. Nga 10 situata të ndryshme mesatarja e atyre që thanë që korrupsioni është plotësisht i papranueshëm ishte rreth 87%, gjersa vetëm 3.3% e të anketuarve ishin të mendimit që korrupsioni është plotësisht i pranueshëm. Sipas rezultateve, kundërshtimi i korrupsionit ishte më i lartë në gjykata, polici, institucione arsimore dhe dogana, në anën tjetër toleranca më e lartë ishte në spitale apo qendra të mjekësisë familjare, në situata për të gjetur punë, dhe për të nxjerrë certifikata në komunë.

Toleranca më e lartë ndaj korrupsionit ishte “për të gjetur punë”, ku rreth 10% e respondentëve raportuan është e pranueshme për një person që të jap para, dhuratë ose ndonjë shërbim për të gjetur punë në institucionet e ndryshme publike.

Figura 6. Pranueshmëria e korrupsionit në institucione dhe situata të ndryshme




Është me rëndësi që të theksohet që nuk është gjetur ndonjë lidhshmëri ndërmjet tolerancës dhe faktorëve të ndryshëm demografik, si gjinia, mosha dhe edukimi. I vetmi korrelacion me faktorët demografik është parë me të ardhurat mujore personale ku është vërejtur një lidhshmëri negative e ultë por e rëndësishme. Pra, sipas rezultateve sa më shumë të ardhura që kanë respondentët aq më tolerant ndaj praktikave korruptive janë paraqitur ata.

Të pyetur nëse ishin të gatshëm të ofronin mito (ryshfet) ndonjë zyrtari për të zgjedhur një problem të madh në institucione publike, rreth 67% të respondentëve raportuan që nuk do të ofronin mito, ndërsa 33% raportuan që do të mund të ofronin mito në situata të caktuara. Nga ata që do të ofronin mito, është me rëndësi që pjesa dërmuese do të ofronin mito vetëm nëse nuk do të kishte ndonjë mundësi tjetër për të zgjedhur problemin. Në anën tjetër nga ata që do të refuzonin ofrimin e mitos, 26% do të lajmëronin rastin në polici, kjo shifër mund të konsiderohet e ulët nëse e krahasojmë tolerancën e ultë të raportuar ndaj korrupsionit

Shumica absolute e qytetarëve nuk kanë tolerancë ndaj korrupsionit (87% plotësisht e papranueshme dhe rreth 6% e papranueshme), por në të njëjtën kohë nëse janë të detyruar që të ofrojnë mito (ryshfet) për të zgjedhur ndonjë problem të madh me institucionet publike një e treta e respondentëve (33%) raportuan që do të mund të ofronin mito (ryshfet). Në këtë aspekt, edhe pse shumica e njerëzve në Kosovë i kuptojnë dhe i njohin sjelljet korruptive, vetëm një në katër qytetarë është i gatshëm të raportoj sjelljet korruptive. Pjesëmarrësit në fokus grupe shprehën hezitim dhe frikë për të raportuar korrupsionin, dhe kanë humbur besimin se institucionet do t'i zgjidhin ato raste në mënyrë efektive dhe me kohë. Në Prizren, pjesëmarrësit në fokus grup theksuan se frika është një ndër arsyet kryesore pse njerëzit nuk ankohen. Për shembull, në rast të punësimit me të njofshëm, qytetarët nuk ankohen për shkak që mund t'i humbin përfundimisht gjasat për t'u punësuar në të ardhmen, dhe nuk shohin ndonjë shembull të ndonjë rasti të raportuar që ka rezultuar në ndonjë përfitim për ta, apo për publikun në përgjithësi.

Edhe pse shumica e qytetarëve për shumë dimensione të sjelljeve korruptive thonë që janë plotësisht të papranueshme, nga fokus grupet dhe intervistat na del që tolerimi i korrupsionit është më i lartë në krahasim me atë që është raportuar nga respondentët. Saktësisht, shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe thonë që toleranca e korrupsionit është e lartë dhe njerëzit nuk e raportojnë korrupsionin ngase nuk e shohin atë si ndonjë krim të madh. Këtu duhet të theksohet se disa nga pjesëmarrësit, thonë që tanimë nuk mund të flasim për tolerimi e korrupsionit por për normalizimin e tij sidomos në institucionet shëndetësore. Sipas pjesëmarrësve është bërë normale që të blihen barnat që duhet të jenë falas në spitale, që të bëhen analiza tek ordinancat private edhe pse laboratorët në spitale ekzistojnë, që të paguhet mjeku për operacion apo anestezion edhe pse operimi bëhet në spital.


Figura 7. Ju personalisht, a do t'i jepnit mito zyrtarit i cili në mënyrë të hapur kërkon para për t'iu zgjidhur ndonjë problem të madh tuajin?



Në aspektin e përgjigjeve në pyetjen “a do të jepnit mito zyrtarit i cili në mënyrë të hapur kërkon para për t'iu zgjidhur ndonjë problem të madh të juaj?” ka dallime të vogla ndërmjet femrave dhe meshkujve, dallime pak më të theksuara janë në përgjigjen “nuk do të paguaja por do të paraqisja në polici” ku rreth 29% të meshkujve kanë zgjedhur këtë opsion në krahasim me 23% të femrave.

Në pyetjen e njëjtë përgjigjet janë analizuar për të shikuar gatishmërinë e të anketuarve që rastet ti paraqesin në polici. Sipas rezultateve, numri i atyre që kanë thënë që nuk do të paguanin ryshfet dhe rastin do të lajmëronin në polici është më i lartë në rajonin e Gjilanit, të Prishtinës dhe të Pejës, ndërsa me i ultë në rajonin e Gjakovës, Prizrenit dhe Mitrovicës. Në këtë aspekt rajoni i Gjakovës dallohet shumë nga rajonet tjera për nga numri i ultë që do të raportonin rastin në polici, por nga analizat nuk mund të përcaktohen shkaqet e dallimit në aspektet tjera demografike.

Figura 8. Nuk do të paguaja dhe do të lajmëroja rastin në polici




Po ashtu sipas rezultateve, gatishmëria për të lajmëruar rastin në polici është më e lartë tek shqiptarët me 28%, pastaj tek serbët me 20% dhe komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptas me 3%, gjersa tek komunitetet tjera asnjë respondentë nuk ka zgjedhur këtë opsion.

Në një nga fokus grupet pjesëmarrësit theksuan se nuk raportohet korrupsioni ngase në shumë raste asgjë nuk ndodhë e as mediat nuk bëjnë publike raportimet e korrupsionit dhe nepotizmit, sidomos rastet e nivelit të ulët. Për shembull, nga fokus grupi në Mitrovicë u pa që një nga perceptimet e larta të korrupsionit në Mitrovicë ishte në Universitetin e Mitrovicës. Sipas pjesëmarrësve punësimet aty ishin të bazuara kryesisht në lidhje familjare dhe shumica e të punësuarve ishin të lidhur familjarisht. Njëri nga pjesëmarrësit theksoi se iu është afruar mediave me fakte të lidhjeve familjare në Universitetin e Mitrovicës, dhe kjo thjesht ishte injoruar nga këto të fundit. Kjo në një mënyrë reflekton edhe përfshirjen e mediave në këtë qark të mosreagimit dhe përforcimit të një praktike negative të raportuar sipas pjesëmarrësve.

Qytetarët po ashtu u pyetën se çfarë mendojnë për punësimet në sektorin publik. Shumica e qytetarëve ishin të mendimit që kualitetet dhe aftësitë personale ishin të rëndësishme për punësim. Rreth 45% mendojnë që arsimi është me rëndësi, pasuar nga përvoja profesionale me rreth 27% dhe trajnimet profesionale 4%. Në anën tjetër format korruptive si ryshfeti, lidhjet familjare, miqtë dhe përkatësia partiake u paraqitën si të rëndësishëm nga rreth 22% të të anketuarve.

Figura 9. Përgjigjet e respondentëve kur janë pyetur se çka konsiderojnë të rëndësishëm për punësim në sektorin publik?



Edhe pse vetëm 22% e të anketuarve ishin të mendimit që praktikat korruptive ishin me rëndësi në punësimet në sektorin publik, në fokus grupe dhe intervista pjesëmarrësit ishin të mendimit që praktikat korruptive janë mënyra kryesore për tu punësuar në institucione publike. Në fokus grupin e Mitrovicës, pjesëmarrësit raportuan që shumica e të punësuarve në Universitetin e Mitrovicës ishin të punësuar përmes lidhjeve familjare, dhe se shumica e stafit akademik aty nuk kanë kualifikimet e duhura për të ligjëruar. Të njëjtën e deklaruan edhe për punësimet në kompaninë Trepça, ata thonë që shumë njerëz as që aplikojnë në konkurse ngase paraprakisht dihet se kush do të punësohet në konkursat e shpallura. E njëjta gjë është raportuar edhe për Universitetin e Prizrenit dhe punësimet e stafit akademik dhe jo-akademik në këtë institucion. Sipas një të intervistuarit ky institucion ishte bërë si nëndegë e partive në pushtet. Ngjashëm, sipas pjesëmarrësve në fokus grupin në Prishtinë shpesh njerëzit nuk aplikojnë në konkurse pasi që mendohet se ato janë të aranzhuara për personat të caktuar apo për persona që më parë janë angazhuar me kontrata afatshkurtra.


Qytetarët gjithashtu u pyetën nëse ekziston korrupsioni në institucionet e ndryshme publike dhe private në Kosovë. Sipas rezultateve qytetarët mendojnë që në shumicën e institucioneve publike ekziston korrupsion i nivelit të lartë, kjo shifër kalon 50% për 12 entitete publike (duke mos përfshirë Ministrinë), gjersa vetëm për katër institucione publike perceptimi që ka korrupsion në nivel shumë të lartë nuk kalon 50%.

Nga institucionet e ndryshme publike, ministritë konsiderohen si institucione ku ka prezencë të korrupsionit në nivel shumë të lartë nga 71% të respondentëve, pastaj në zyrën e kryeministrit me 69%, dhe partitë politike me 65%. Rreth 63% e të anketuarve mendojnë që ekziston korrupsion në nivel shumë të lartë në Kuvendin e Kosovës, pastaj në Gjykatat e Kosovës me 62%, dhe Prokurori me 61%.

Në anën tjetër organizatat e shoqërisë civile janë në fund të listës së perceptimit të korrupsionit ku rreth 27% të qytetarëve mendojnë që në këto organizata ka korrupsion në nivel shumë të lartë, pastaj vinë bankat me rreth 31% të qytetarëve që mendojnë se korrupsioni i lartë ekziston në to dhe organizatat ndërkombëtare me rreth 32% të qytetarëve.

Është me rëndësi të theksohet që perceptimi i korrupsionit është parë edhe tek mediat me rreth 37% të qytetarëve që mendojnë që ka korrupsion të nivelit të lartë, po ashtu rreth 35% mendojnë njëjtë për sektorin privat. Rreth 48% të qytetarëve mendojnë që ka korrupsion të nivelit të lartë në Policinë e Kosovës, gjersa 18% mendojnë që këtu ka korrupsion por në nivel të ultë.

Figura 10. Perceptimi i pranisë së korrupsionit në nivel shumë të lartë dhe në nivel të ultë në institucionet e ndryshme publike dhe private në Kosovë



Sipas pjesëmarrësve të fokus grupeve rezultatet e anketës janë të kuptueshme dhe në përputhje me pritjet e tyre lidhur me korrupsionin. Ministritë dhe kryeministria kanë dalur në krye të listës ngase këto operojnë me buxhetin dhe korrupsioni më i madh sipas pjesëmarrësve të fokus grupeve ndodhë me tenderë dhe kontraktimet e qeverisë, po ashtu edhe në subvencionet e ministrive ka korrupsion.


Sipas një pjese të pjesëmarrësve të fokus grupeve përqindja e lartë e perceptimit të korrupsionit për institucionin e Kuvendit të Kosovës dhe Presidencës nuk është në përputhje me buxhetin dhe mandatin e tyre. Sipas tyre, këto institucione për shkak të buxhetit të ulët dhe mandatit të limituar legjislativ nuk mund të kenë me të vërtetë korrupsion me nivel të lartë, por sipas interpretimit të pjesëmarrësve kjo mund të ndodhë për shkak të mënyrës se si u zgjedh

presidenti në një seancë të zgjatur të Kuvendit dhe raportimeve për shkëmbimin e votave për pozita diplomatike, terminale doganore apo interesa të tjera të një pjese të deputetëve. Po ashtu edhe pse nuk ka pasur pyetje të drejtëpërdrejtë për aferat e fundit me inçizimet që kanë dalur në mediat elektronike, kjo çështje është shtruar nga vetë pjesëmarrësit e fokus grupeve, sipas pjesëmarrësve perceptimet e larta për korrupsionin në Presidencë dhe në Kuvendin e Kosovës mund të jenë si pasojë e aferës "Pronto" ku sipas tyre ndër protagonistë dalin të jenë edhe Presidenti dhe Kryetari i Kuvendit të Kosovës.

Për shumë pjesëmarrës të fokus grupeve dhe intervistave është e kuptueshme po ashtu pse dalin perceptimet aq të larta për gjykatat e Kosovës dhe për Prokurorinë, ngase aty ka korrupsion të madh dhe mospunë. Sipas pjesëmarrësve, gjykatësit në shumë raste bëjnë pazare për zvogëlimin e dënimit të kriminelëve dhe në vend të dënimeve normale në shumë raste gjykatësit i dënojnë kriminelët me dënime minimale. Po ashtu sipas pjesëmarrësve performanca e dobët e gjykatave dhe prokurorëve ka bërë që niveli i korrupsionit në Kosovë të jetë kaq i lartë, disa po ashtu kanë shprehur dëshpërimin me mospunën e EULEX-it në këtë drejtim.


Perceptimet lidhur me prezencën e korrupsionit në të gjitha institucionet janë mbledhur dhe është kalkuluar mesatarja e perceptimit të korrupsionit për të gjithë respondentët. Specifikisht mesatarja është kalkuluar nga përgjigjet në njëzet e një (21) pyetjet lidhur me perceptimin e korrupsionit në institucionet e ndryshme, minimumi i pikëve të mundshme ka qenë zero, gjersa maksimumi i pikëve katër. Sipas rezultateve pothuajse të gjithë mendojnë që ka korrupsion të nivelit të lartë në të gjitha institucionet. Sipas analizave mesatarja për gjithë mostrën ishte 3.23 dhe devijimi standard 0.6, që do të thotë që shumica e respondentëve ishin të mendimit që ka një korrupsion të nivelit të lartë në shumicën e institucioneve. Në aspektin e determinantëve të perceptimit të korrupsionit nuk ka dallime të theksuara në perceptimin e korrupsionit, sipas gjinisë, moshës, vendbanimit, apo edukimit. Një dallim i theksuar dhe i rëndësishëm vërehet vetëm tek etnia dhe regjioni. Sipas analizave perceptimi i korrupsionit është më i lartë tek shqiptarët, pastaj tek komunitetet boshnjak, turk dhe goran, gjersa më i ultë ishte tek komuniteti serb. Në aspektin regjional perceptimi i korrupsionit ishte më lartë në regjionin e Prishtinës dhe të Mitrovicës, ndërsa me i ultë në regjionin e Gjakovës dhe të Ferizajit.

Figura 11. Mesatarja e perceptimit të korrupsionit sipas etnisë



Të pyetur se nga i kishin krijuar mendimet e tyre rreth prezencës së korrupsionit në institucione, rreth 60% të respondentëve raportuan që mendimet e tyre bazohen në raportimet e mediave, 15% bazohen në bisedat me shokë, shoqe apo familjarë, rreth 13% në përvojat e përjetuara personale, dhe rreth 12% në përjetimet e të afërmeve të tyre (shokë, shoqe apo familjarë).


Figura 12. Burimi i vlerësimit për prezencën e korrupsionit në insitucione



Edhe në fokus grupe shumë nga pjesëmarrësit ishin të mendimit që mediat ose lajmet që dalin në media formojnë opinionet e njerëzve lidhur me korrupsionin por sipas tyre edhe burime të tjera të informatave apo faktorëve krijojnë perceptimin ndaj korrupsionit, ndër këto më të rëndësishmet janë edhe përvojat personale dhe të afërmeve të tyre. Një konsensus në mes të pjesëmarrësve ishte se në periudhën e fundit, raportimi medial i bisedave telefonike ka shpërfaqur nivelin e thellë të korrupsionit dhe kjo ka vërtetuar atë që ndoshta më herët është supozuar, por tani më e vërtetuar përmes vetë akterëve politikë që kanë ndërmjetësuar në vendime të ndryshme. Pra mediat janë përcaktues themelor i perceptimit e pastaj përvojat personale apo të të afërmeve.


Nga pyetja paraprake u përcaktua që rreth 13% të qytetarëve kishin formuar perceptimet e tyre për korrupsionin nga përjetimet personale, për të shikuar më shumë përjetimin e korrupsionit respondentët u pyetën nëse kishin pasur eksperiencë të situatës ku ata ishin të kushtëzuar nga zyrtarët publik për të paguar para (ryshfet), shpërblime apo favore tjera në mënyrë që të marrin shërbimin e kërkuar publik. Sipas rezultateve rreth 13% të qytetarëve janë përgjigjur që kanë përjetuar në gjë të tillë në të kaluarën.

Figura 13. Përjetimi i kushtëzimit (korrupsionit) në institucione publike/shtetërore



Në aspektin e përjetimit të kushtëzimit nëse nga kalkulimi hiqet numri i atyre që nuk janë përgjigjur, përqindja e personave që kanë përjetuar kushtëzim të shërbimeve publike rritet në 14.4%. Kjo shifër është pak më e lartë tek meshkujt (17.5%) në krahasim me femrat (11.4%).


Figura 14. Përjetimi i kushtëzimit (korrupsionit) në institucione publike/shtetërore sipas gjinisë



Është interesante që kur respondentët u pyetën se në cilin institucion kanë përjetuar kushtëzimin ka dalur që shifra e atyre që janë kushtëzuar të jetë më e lartë në krahasim me numrin e atyre që kanë raportuar korrupsionin në një pyetje më lartë. Sipas kësaj pyetje, numri i atyre që kanë përjetuar kushtëzim në institucione është rreth 16.5%. Këto rezultate tregojnë që ka një ngurrim të theksuar tek qytetarët që të paraqesin rastet e korrupsionit drejtpërdrejtë dhe në këtë aspekt ndoshta përgjigjet në këtë pyetje tregojnë në mënyrë më reale gjendjen e vërtetë.


Nga ata që kanë raportuar që në të kaluarën iu është kërkuar ryshfet, shpërblime apo favore tjera nga ana e zyrtarit për të marrë ndonjë shërbim nga institucionet publike/shtetërore, shumica kanë raportuar që këtë kushtëzim e kanë përjetuar në spitale (27%), pastaj në komunë (16%) dhe ministri (11%). Është me rëndësi të theksohet që një numër i konsiderueshëm i respondentëve kanë theksuar që kanë qenë të kushtëzuar edhe në sektorin privat, rreth 14%. Ky rezultat nuk është pritur, por mbase rezultatet tregojnë që praktikat korruptive janë të përhapura edhe në sektorin privat, gjetje që përkrahet edhe nga diskutimet në intervista dhe fokus grupe.

Figura 15. Institucionet në të cilat respondentët kanë qenë të kushtëzuar nga zyrtarët për ofrimin e shërbimeve




Në aspektin gjinor vërehen dallime të vogla në aspektin e institucioneve ku kanë përjetuar kushtëzim meshkujt dhe femrat. Gjersa spitalet janë institucioni i cili përmendet më së shumti nga të dyja gjinitë, ka rreth 6% më shumë femra që kanë përjetuar korrupsion në spitale në krahasim me meshkujt. Në anën tjetër numri i meshkujve që raportuan për kushtëzime në komuna është rreth dyfishi i femrave. Pothuajse e kundërta është në rastin e sektorit privat ku më shumë femra kanë raportuar kushtëzime sesa meshkujt, i njëjti trend vërehet edhe në shkolla ku shumë më shumë femra kanë përjetuar kushtëzim në krahasim me meshkujt, dhe së fundi asnjë femër nuk ka raportuar të ketë qenë e kushtëzuar me praktika korruptive në Administratën Tatimore të Kosovës gjersa rreth 8% i meshkujve kanë raportuar këtë praktikë.

Figura 16. Përjetimi i korrupsionit në institucione të ndryshme sipas gjinisë




Nga ata që kanë përjetuar kushtëzimet rreth 37% kanë raportuar që kjo ka ndodhë vetëm një herë në jetën e tyre, rreth 24% të qytetarëve kjo ju ka ndodhur dy raste, rreth 17% kanë përjetuar 3 deri në 5 raste të kushtëzimit me korrupsion dhe rreth 6% më shumë se 5 raste të kushtëzimit.

Figura 17. Sa herë kanë përjetuar kushtëzimin e shërbimeve me praktika korruptive, prej atyre që kanë përjetuar kushtëzime



Çdo i treti qytetarë që ka qenë i kushtëzuar ka pranuar të ofroj ryshfet, dhuratë apo favore tjera në këmbim të shërbimit nga zyrtari publik. Nëse kanë qenë të kushtëzuar, 70% e tyre kanë dhënë atë që iu është kërkuar, ndërsa 30% nuk kanë pranuar.

Figura 18. Përqindja e qytetarëve që kanë qenë të kushtëzuar dhe kanë pranuar të ofrojnë ryshfet, dhurata apo favore tjera



Në aspektin e analizave demografike të atyre që kanë qenë të kushtëzuar dhe që kanë pranuar të ofrojnë para, favore apo ndonjë shpërblim nuk mund të bëjmë krahasime të besueshme në bazë rajonale. Po ashtu nuk mund të bëjmë krahasime ndërmjet të gjitha etnive që jetojnë në Kosovë ngase shumë pak pjesëtarë të komuniteteve tjera jo-serbe kanë raportuar për këtë çështje, por në bazë të analizave mund të themi që shqiptarët janë më të gatshëm të pranojnë kushtëzimet dhe t'i binden zyrtarëve (31%) në krahasim me serbët (20%). Po ashtu meshkujt (32%) raportojnë që pranojnë të plotësojnë kushtëzimet e zyrtarëve pak më shpesh në krahasim me femrat (27%).

Edhe pse nuk ka dallime të rëndësishme (për shkak të numrit të vogël të respondentëve që kanë përjetuar kushtëzimet) dhe nuk mund të vërehet një trend i qartë, mund të themi që ata që nuk kanë të ardhura dhe ata që kanë të ardhura më të ulëta (nga 1 deri në 150 euro në muaj) kanë pranuar kushtëzimin më së shumti, përqindja ka rënë tek grupi me të ardhura nga 151 deri në 300 euro dhe pastaj prap ka pasur rënie tek grupet me të ardhura më të larta.


Tabela 1. Përqindja e atyre që kanë pranuar të japin ryshfet në situatat ku kanë qenë të kushtëzuar sipas të ardhurave.

Nëse po, a keni dhënë ato që iu është kërkuar	Nuk ka të ardhura	1-150 euro	150-300 euro	301-500 euro	501-750 euro	Më shumë se 1000 euro
Po	32.76%	42.86%	23.81%	36.59%	23.08%	23.53%
Jo	67.24%	57.14%	76.19%	63.41%	76.92%	76.47%
Total	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

Në këtë pyetje është interesante të specifikohet që përgjigjet nuk kanë dalluar sipas arsimimit, gjersa mund të ketë pritje që njerëzit me edukim më të lartë do të refuzonin më shumë kushtëzimet për ryshfet, nuk është parë një trend i qartë që njerëzit me arsimim më të lartë të kenë thënë më shumë jo kushtëzimeve të zyrtarëve publik për ryshfet. Në anën tjetër moshë ka

dalë si një përcaktuese e fortë e pranimi të kushtëzimeve nga ana e zyrtarëve publik, sa më i vjetër respondentit aq më të mëdha ishin gjasat që ata të pranojnë kushtëzimet e zyrtarëve për ryshfet.


Figura 19. Përgjigjet e të anketuarve që janë përgjigjur me "Po" në pyetjen "Nëse keni qenë të kushtëzuar a keni dhënë atë që ju është kërkuar nga ju" sipas grupmoshave



Në përgjithësi, në fokus grupe mendimi i shumë pjesëmarrësve ishte që ekziston një gatishmëri e lartë tek qytetarët për të paguar diçka për të kryer shpejt punën në institucionet publike. Sipas tyre përqindja e njerëzve që do të paguanin për të kryer punët e veta shpejt është e lartë, kjo me siguri varet edhe prej urgjencës së shërbimit të kërkuar, prandaj në institucionet shëndetësore njerëzit paguajnë ngase janë në urgjencë. Kjo në një mënyrë argumenton pajtimin se për të kryer punët e rëndësishme mund të kërkohej që të paguhej diçka dhe se kjo disi është e pranueshme për pjesëmarrësit.


Në aspektin e ndikimit të përjetimit të kushtëzimit në perceptimin e korrupsionit, njohjes së korrupsionit dhe kundërshtimit të saj vlen të theksohet se përjetimi i kushtëzimit ka ndikim në rritjen e perceptimit të qytetarëve që ka korrupsion të nivelit të lartë në institucione, edhe pse mesataret e të dy grupeve në perceptimin e korrupsionit janë të përafërta testet statistikore vërtetojnë që dallimi është i rëndësishëm. Në anën tjetër nuk ka dallime të rëndësishme ndërmjet atyre që kanë përjetuar personalisht korrupsionin dhe atyre që nuk kanë përjetuar personalisht në njohuritë e tyre se çka është korrupsioni, po ashtu nuk ka dallime të rëndësishme në kundërshtimin e korrupsionit ndërmjet këtyre dy grupeve.

Figura 20. Mesatarja e percetimit të korrupsionit, njohjes së korrupsionit dhe kundërshtimit të korrupsionit sipas përjetimit personal të korrupsionit



Në aspektin e formave të kushtëzimit shumica e qytetarëve kanë qenë të kushtëzuar për ryshfet (mito) në formë të parasë (63%), pastaj përmes kthimit të një favorit më një favor tjetër (16%), gjersa dhënia e dhuratës/shpërblimit është raportuar nga 15% i atyre që ishin të kushtëzuar, së fundi rreth 6% kanë raportuar forma tjera të kushtëzimit.


Figura 21. Format e raportuara të kushtëzimit nga qytetarët që kanë përjetuar raste të kushtëzimit korruptiv



Nga ata që nuk kanë përjetuar raste të kushtëzimit të shërbimeve gatishmëria për raportimin e korrupsionit është më e lartë, në krahasim me respondentët në përgjithësi. Edhe pse në pyetjen paraprake vetëm 26% kanë thënë që do të raportonin korrupsionin në polici, ata që nuk kishin përjetuar kushtëzim të shërbimeve nga ana e zyrtarëve publik raportuan që nëse do të ishin përballur me një gjë të tillë, 53% e tyre do ta raportonin rastin në polici. Në këtë aspekt, është indikative se qytetarët të cilët nuk kanë pasur eksperiencë të drejtëpërdrejtë të korrupsionit ishin më të gatshëm për të raportuar korrupsionin në krahasim me qytetarët që kishin përjetuar kushtëzimin. Këto rezultate në njëfarë mënyre tregojnë për rritjen e apatisë në raport me korrupsionin tek qytetarët që kanë përjetuar kushtëzimet e shërbimeve publike nga zyrtarët publik.

Gatishmëria për të raportuar në polici po ashtu dallonte për nga etniciteti, shqiptarët (55%) shprehën gatishmërinë më të lartë se serbët (42%), dhe komunitetet boshnjak, turk dhe goran (33%) dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (21%) për të raportuar korrupsionin në polici.

Figura 22. Përgjigjet e respondentëve për gatishmërinë për të paraqitur rastin korruptiv në polici sipas grupit etnik




Në aspektin regjional gatishmëria më e lartë për të raportuar korrupsionin nga ana e atyre që nuk kishin përjetuar kushtëzimin korruptiv nga ana e zyrtarëve publik ishte në rajonin e Gjilanit (72%), pasuar nga rajoni i Gjakovës (64%) dhe rajoni i Ferizajit (59%), gjersa gatishmëria më e ultë për të raportuar rastet në polici ishte në rajonin e Prizrenit (31%) dhe rajonin e Mitrovicës (45%).

Në këtë aspekt këto rezultate janë vetëm nga grupi i atyre që nuk kanë qenë të kushtëzuar, prandaj gatishmëria për të raportuar është më e lartë në krahasim gatishmërinë e raportuar në pyetjen “Ju personalisht, a do të jepnit mito zyrtarit i cili në mënyrë të hapur kërkon para për t’iu zgjidhur ndonjë problem të madh të juaj?” (Figura 8) ngase në këtë pyetje janë përgjigjur të gjithë të anketuarit. Pra kur në këtë pyetje përgjigjen edhe ata që kanë përjetuar kushtëzimin gatishmëria për raportim bie në krahasim vetëm me ata të anketuar që nuk kanë përjetuar kushtëzimin korruptiv.

Vlen të theksohet po ashtu që sa më të arsimuar respondentët aq më e lartë është gatishmëria e tyre për të paraqitur rastet në polici. Gatishmëria më e ultë ishte takata që nuk kanë shkollim formal me 35%, gjersa më e larta ishte tek ata që kishin kryer ose ishin në studime pas-universitare me 61%.


Figura 23. Përgjigjet e respondentëve për gatishmërinë për të paraqitur rastin korruptiv në polici sipas nivelit të arsimimit



Të pyetur lidhur me opinionet e tyre për shkaqet e korrupsionit, shumica e respondentëve mendojnë që mungesa e llogaridhënies qeveritare është shkaku kryesor me 36%, pastaj dëshira për pasurim të shpejtë të zyrtarëve me 30%, dhe pagat e ulëta të zyrtarëve në sektorin publik me 15%.

Në aspektin kumulativ, kur përgjigjet për shkakun kryesor dhe dytësor bashkohen, 63% e respondentëve mendojnë që dëshira për pasurim është arsyeja e korrupsionit e pasuar me 54% të respondentëve që mendojnë që shkaku është mungesa e llogaridhënies qeveritare, gjersa mos-efikasiteti i sistemit gjyqësor shihet si shkak i korrupsionit nga ana e 35% të respondentëve


Figura 24. Opinionet lidhur me shkaqet kryesore për prezencën e korrupsionit



Në aspektin e dallimeve demografike nuk ka pasur dallime të rëndësishme sipas gjinisë në përzgjedhjen e faktorëve kryesor të shkaqeve të prezencës së korrupsionit. Në anën tjetër kur përgjigjet në këtë pyetje janë analizuar sipas etnicitetit kanë dalur dallime të rëndësishme në përgjigje. Specifikisht, për shqiptarët faktori kryesor i ekzistimit të korrupsionit ishte “mungesa e llogaridhënies qeveritare”, për komunitetin serb dhe komunitetin boshnjak, turk dhe goran ishte “dëshira për pasurim të shpejtë”, gjersa për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas ishin “pagat e ulëta të zyrtarëve në sektorin publik”.


Rreth 43% të respondentëve mendojnë që ndërrimi i qeverisë është me rëndësi për luftimin e korrupsionit, pasuar nga funksionalizimi i gjykatave me 26% dhe ndërrimi i mentalitetit të qytetarëve me 18%. Në fokus grupin në Prishtinë, pjesëmarrësit ishin kryesisht të mendimit që një reformë e thellë në gjyqësorë dhe prokurori, përmes së cilës njerëzit ndërtojnë besim për të dorëzuar raste, do të ishte mënyrë e mirë për të luftuar korrupsionin, edhe pse pak pjesëmarrës besojnë që kjo reformë është e mundur me klasën aktuale politike. Gjithashtu, në fokus grupe ishte propozuar që një mënyrë për të luftuar korrupsionin është që të edukohen qytetarët për të drejtat e tyre, dhe shërbimet që i ofrojnë institucionet shtetërore.

Figura 25. Opinionet e qytetarëve rreth asaj se çka duhet të bëhet për luftimin e korrupsionit



Kur kjo pyetje është analizuar në bazë të faktorëve demografik nuk ka pasur dallime të rëndësishme sipas gjinisë, vendbanimit, apo regjionit, edhe në këtë pyetje dallimet të rëndësishme kanë dalur të janë në bazë të etnive dhe na bazë të rajonit. Përveç komunitetit serb që si faktor kyq për luftimin e korrupsionit e sheh funksionalizimin e gjykatave dhe punën më të mirë të policisë serbëve, të gjitha komunitetet tjera kanë qenë të mendimit që për të luftuar korrupsionit duhet ndërrimi i qeverisë. Ndërrimi i mentalitetit të qytetarëve ka qenë si faktori i dytë më i rëndësishëm tek komunitetet boshnjak, turk dhe goran, tek shqiptarët faktori i dytë me rëndësi për luftimin e korrupsionit ishte funksionalizimi i gjykatave, gjersa tek komuniteti rom, ashkali, dhe egjiptian ishte puna më e mirë e policisë. Rekomandime të ngjashme u dhanë edhe në fokus grupe dhe intervista.

Figura 26. Opinionet e qytetarëve rreth asaj se çka duhet të bëhet për luftimin e korrupsionit



2. GJETJET NGA INTERVISTAT

Në këtë pjesë të raportit prezantohet një përmbledhje e intervistave të bëra me 25 persona të intervistuar nga sektorë të ndryshëm përfshirë përfaqësues të mediave, organizatave jo-qeveritare, institucioneve shtetërore dhe kompanive private.

Në përgjithësi, të intervistuarit pranojnë se korrupsioni në Kosovë është realitet, dhe jo vetëm perceptim. Të intervistuarit theksuan se korrupsioni është i përhapur në pothuajse të gjithë sektorët duke përfshirë ministrinë, komunat, prokuroritë, gjykatat, dhe bizneset. Ngjashëm me gjetjet në fokus grupe, të intervistuarit vendosën theks më të veçantë në institucionet e shëndetësisë dhe të arsimit, dhe shpesh e përmendën mungesën e angazhimit të prokurorëve dhe gjykatave për të luftuar korrupsionin.

Sa i **përket institucioneve shëndetësore**, të intervistuarit shprehën shqetësimin në lidhje me menaxhimin e spitaleve, dhe theksuan se probleme si mungesa e materialeve shpenzuese, mungesa e aparaturave dhe mos-funksionimi i tyre, lista e pritjeve, dhe mungesa e mbikëqyrjes shkaktojnë uljen e besimit të publikut në këto institucione. Të intervistuarit theksuan se nganjëherë spitalet u shërbejnë mjekëve si vend për të `rekrutuar` pacientë për spitalet apo ordinancat e tyre private.

Një gjetje tjetër shpesh e përmendur në intervista, ishte se korrupsioni mund të gjendet në **institucionet arsimore** të niveleve të ndryshme, duke filluar prej korrupsionit në regjistrimin e fëmijëve në çerdhe dhe shkolla fillore, duke vazhduar me probleme të kopjimit si në rastin e testit të maturës në shkolla të mesme, duke vazhduar me regjistrimin/punësimin në fakultete pa përmbushje të kriterëve, e deri në publikimin e temave të diplomës përmes plagjiaturës. Gjithashtu, sipas ekspertëve të arsimit, ekziston një perceptim që mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave janë në pozitë të tyre falë nepotizmit, dhe se mësimdhënësit ofrojnë kurse plotësuese të cilat shpesh shihen si parakusht për përmirësimin e notës, pra një lloj kushtëzimi. Një i intervistuar u shpreh se në fakultetet e mjekësisë dhe juridikut, së pari regjistrohen fëmijët e mjekëve, avokatëve, gjykatësve, prokurorëve, politikanëve, pastaj ata me ryshfet, përderisa meritoret shpesh humbin mundësinë.

Sipas të intervistuarve, fakti që **Prokuroria** është në mesin e institucioneve më të korruptuara, tregon që shpresat për të luftuar korrupsionin janë ende të vogla, dhe ky duhet të shërbejë si një alarm për Prokurorinë që të fillojë veprimet konkrete për të luftuar këtë perceptim. Ngjashëm vlen edhe për **Gjykatat**, të cilat duhet të kenë një strategji dhe me veprime konkrete t'i dëshmojnë publikut që punën e kryejnë ndershmërisht dhe pa korrupsion. Sipas të intervistuarve, nëse **Gjykata, Prokuroria dhe Policia** do të kishin perceptim më të ulët sa i përket korrupsionit,

atëherë padyshim që edhe sektorët e tjerë do të kishin perceptim më të ulët ngase qytetarët do të besonin në mekanizmat e thirrur për të parandaluar korrupsionin në institucione të tjera si Kryeministri, Ministri apo institucione të tjera publike. Sipas të intervistuarve, në Kosovë duhet të krijohet rol-modeli i gjykatësit, prokurorit, policit, të cilët janë të gatshëm dhe dëshmojnë se dijnë dhe mund ta luftojnë korrupsionin, e kështu të shërbejnë si shembull për të mirë për të tjerët.

Sipas të intervistuarve, **komunat** gjithashtu kanë problem të madh më perceptimin për korrupsion për faktin se ato janë adresa e parë që ofrojnë shërbimet bazike për qytetarë, përfshirë çerdhe, shkolla fillore, shkolla të mesme, ofrimi i bursave e subvencioneve, shtrimi i rrugëve, ambulancat, spitalet dhe shërbime të tjera lokale. Këto janë obligime që kryesisht nuk përkthehen në para ose ryshfet por në sigurimin e votave për kandidatët e preferuar të ofruesit të shërbimit specifik. Në këtë drejtim, shkollat dhe aktivitetet dhe rreth tyre vazhdimisht janë një mundësi e mirë për të thithur votues përmes keqpërdorimit ose favoreve. Gjithashtu, në komuna vërejmë shpenzime të vogla të parasë publike që ofrohen për përkrahës ose përkrahës potencial të partive politike përmes kontratave të vogla nën 5 mijë euro, e që nuk shkojnë përmes procedurave të prokurimit publik. Ngjajshëm janë edhe kontratat mbi vepër që lëshohen nga komunat, që shihen si mënyrë për të punësuar njerëz pa kriteret profesionale. Sipas të intervistuarve, mungon një mbikqyrje efikase e komunave nga mediat dhe organizatat jo-qeveritare.

Një gjetje tjetër nga intervistat është se ka korrupsion edhe në sektorin privat. Biznese të caktuara shihen se përfitojnë përmes favoreve ekonomike si duke fituar tender përmes veprimeve korruptive, lëshimit të licencave të ndryshme të operimit, ikjes së tatimeve, dhe veprimeve të ngjashme. Të intervistuarit ngritën edhe problemin e ekonomisë jo-formale, duke shprehur shqetësimin se të dhënat e prezantuara nga Ministria e Financave kanë raportuar për një nivel prej 34% të ekonomisë së zezë, që i shmanget ligjeve dhe rregulloreve.

Për të intervistuarit, ishte shqetësues fakti që qytetarët besojnë që 40% e mediave janë të korruptuara, dhe kjo është situatë do të duhej të ishte shumë alarmante për ofruesit e licencave për media dhe organizatat që kontrollojnë kodin e etikës në media, që urgjentisht të nisin punë në krijimin e rregullit dhe ndërprerjen e praktikave të tilla në media. Gjithashtu, sipas të intervistuarve, është shumë e rëndësishme që gjykatat të nisin me urgjencë të trajtojnë paditë ndaj e mediave për shpifje dhe mos-ofrim të qasjes së barabartë, që do të ndikonte në krijimin e një standardi në media ku nuk ka shkrime të porositura ose paguara.

Një qëndrim tjetër që ishte shprehur në disa intervista ishte se qytetarët nuk janë të informuar mirë se çfarë është apo çfarë pasoja ka korrupsioni, dhe nuk e kuptojnë se cilat veprime mund të konsiderohen si korruptive. Sipas të intervistuarve, korrupsioni nuk është vetëm një transaksion financiar, dhe qytetarët duhet kuptuar se veprimet sikur regjistrimi i fëmijëve me të

njofshëm në çerdhe apo shkollë, hyrja te mjeku pa rend, apo kërkimi i ndonjë shërbimi nga personat me influencë, janë veprime që konsiderohen si korruptive. Shqetësimi i të intervistuarve ishte se këso lloj veprimesh janë tani të normalizuara në shoqërinë tone dhe ndodhin përditë.

Disa të intervistuar kishin përshtypjen se nganjëherë barrën për korrupsion e bartin edhe vetë qytetarët, dhe theksuan se nganjëherë ata janë të gatshëm të paguajnë pa pasur nevojë për shërbime që mjekët, mësuesit, policët apo përfaqësues të tjerë institucional i kanë në përgjegjësi për t'i bërë. Sipas njërit prej të intervistuarve, qytetarët nuk trajtojnë me kujdes problemet e tyre shëndetësore deri sa ato të kalojnë në emergjencë, e atëherë për të marrë shërbimin shëndetësor sa më shpejt, u japin mjekëve para pa u kërkuar askush. Njëjtë mendon edhe një i intervistuar tjetër, që thotë se qytetarët e Kosovës janë të padurueshëm dhe kështu kërkojnë të përfundojnë gjithçka në shpejtësi edhe duke ofruar para, aty ku as nuk u kërkojnë.

Pjesëmarrësit në intervista ofruan disa rekomandime të ndryshme për zgjidhjen e problemit të korrupsionit. Ngjajshëm me gjetjet nga fokus grupet, shumica e pjesëmarrësve në intervista presin që prokuroritë dhe gjykatat të jenë më aktive dhe më efikase në ndjekjen dhe gjykimin e personave që janë të përfshirë në korrupsion. Pjesëmarrësit gjithashtu theksuan nevojën për mbikëqyrje më efektive të institucioneve, përmes kontrolleve të shërbimeve të ofruara, dhe angazhimit të inspektorëve për të kontrolluar këto shërbime. Në mes rekomandimeve të tjera ishte edhe vlerësimi, suspendimi dhe penalizimi i mundshëm i zyrtarëve publik, dhe digjitalizimi i administratës përmes përdorimit të teknologjisë informative.

3. GJETJET NGA SHSTATË FOKUS GRUPET

Në këtë pjesë të raportit paraqiten gjetjet nga shtatë fokus grupet e mbajtura me pjesëmarrës të profileve të ndryshme socio-ekonomike në rajone të ndryshme të Kosovës (Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjakovë, Pejë, Gjiilan dhe Mitrovicë).

Në përgjithësi, pjesëmarrësit në fokus grupe u pajtuan me rezultatet nga anketat për perceptimin publik mbi korrupsionin në Kosovë. Një gjetje e përbashkët nga disa fokus grupe (Prizren, Prishtinë, Ferizaj dhe Gjiilan) ishte se korrupsioni është i përhapur në të gjitha institucionet, por sidomos në institucionet e shëndetësisë. Nganjëherë pjesëmarrësit në fokus grupe ishin të befasisur që gjetjet nga anketat tregonin se spitalet ishin më pak të korruptuara se institucionet e tjera. Pjesëmarrësit në këto fokus grupe treguan raste kur ata personalisht, apo të afërmit e tyre, kanë hasur në veprime korruptive në spitale, për shembull për të paguar për intervenime kirurgjike, për të përshpejtuar procedurat për operim, apo probleme në dhënien e barnave.

Një gjetje tjetër e zakonshme nga fokus grupet (Prizren, Gjakovë, Mitrovicë) ishte se korrupsioni mund të gjendet në institucione akademike. Në Mitrovicë, pjesëmarrësit ishin të mendimit se ka korrupsion në Universitetin e Mitrovicës, duke deklaruar se stafi akademik janë punësuar kryesisht me lidhje familjare edhe pse nuk i kanë përmbushur kriteret që kërkohen për pozitë. Probleme tjera të përmendura janë kopijimet në provime dhe teste, blerja e titujve akademik, dhe plagjiatura në temat e diplomës.

Institucionet tjera shpesh të përmendura për afëra korruptive ishin gjykatat dhe prokuroritë. Në disa fokus grupe madje, pjesëmarrësit kishin pritje që gjykatat dhe prokuroritë të jenë në nivel më të lartë të perceptimit publik për korrupsionin e tyre, pasi që ato nuk kanë luftuar korrupsionin. Pjesëmarrësit në fokus grupe u shprehën se kanë humbur besimin në aftësinë e këtyre institucioneve për të luftuar korrupsionin.

Në fokus grupet në Pejë dhe Gjakovë, pjesëmarrësit kishin vendosur theks të veçantë në korrupsion në organizata jo-qeveritare. Pjesëmarrësit nga fokus grupet në Pejë ishin të mendimit se ka mbi shtatë mijë organizata të regjistruara, prej të cilave shumica nuk janë aktive, por që janë krijuar sa për të marrë fonde një herë ose herë pas here, por pa punuar asgjë. Pjesëmarrësit ngritën çështjen se kush mund të jenë këto organizata fiktive që përfitojnë fonde, sidomos nëse këto fonde alokohen nga institucionet qeveritare. Në Gjakovë, pjesëmarrësit kishin përshtypjen që organizatat jo-qeveritare i bëjnë raportet që të duken mirë, në mënyrë që të mos raportohet gjendja e rëndë që ekziston në Kosovë.

Disa pjesëmarrës në fokus grupe ishin të befasisur me nivelin e lartë të perceptimit të korrupsionit në Presidencë. Sipas pjesëmarrësve në disa fokus grupe (Prishtinë, Ferizaj, Pejë), ky perceptim lidhet më shumë me figurën e Presidentit aktual se sa me institucionin e Presidencës. Disa pjesëmarrës ishin të mendimit që nëse hulumtimi do të bëhej në kohën kur postin e Presidentit e ushtronte znj. Atifete Jahjaga, atëherë do të kishte besueshmëri më të lartë publike në Presidencë.

Një tjetër mendim i përbashkët nga disa fokus grupe ishte që të gjitha institucionet funksionojnë si zingjirë në korrupsion, dhe për këtë arsye nuk mund të vlerësohet se në cilat institucione ka më shumë apo më pak perceptim për korrupsion. Në këtë aspekt, pjesëmarrësit në disa raste deklaruan se institucionet sikur Ministrinë, Gjykatat, Prokuroritë, punojnë së bashku dhe për njëra tjetrën, dhe janë pjesë e këtij zingjiri. Ngjashëm, pjesëmarrësit deklaruan se korrupsioni në sektorin publik dhe privat është paralel, duke theksuar se nuk mund të ekzistoj korrupsioni në sektorin publik, nëse nuk ka kompani të cilat janë të gatshme për të paguar mito (ryshfet) për favore ekonomike, si për shembull fitimin e donjës tenderi.

Kur ishin pyetur për mënyrat se si mund të adresohet problemi i korrupsionit, shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe ishin të pajtimit që nevojitet një angazhim efikas i prokurorive

dhe gjykatave. Pjesëmarrësit në Prishtinë dhe Prizren propozuan që të ndryshohet Kodi Penal që të parashihen dënime më të rënda për veprat kriminale që lidhen me korrupsionin. Pjesëmarrësit vënë theks të veçantë në nevojën që prokuroritë dhe gjykatat të angazhohen në mënyrë aktive duke ngritur aktakuza, duke vendosur gjykime dhe dënime të rënda për personat të cilët gjinden fajtor për korrupsion dhe duke i zgjidhur lëndët me kohë në mënyrë që të shihen rezultatet konkrete të punës së tyre.

Një mënyrë tjetër për të zgjidhur korrupsionin, shpesh e propozuar nga pjesëmarrësit në fokus grupe, ishte edukimi i qytetarëve, në mënyrë që ata t'i njohin të drejtat e tyre si qytetarë, dhe të jenë në dijeni për shërbimet të cilat ofrohen nga institucionet shtetërore. Në Gjakovë, pjesëmarrësit propozuan që mediat t'i informojnë qytetarët për mënyrat se si ata mund të angazhohen për të luftuar korrupsionin. Në fokus grupin në Ferizaj, një pjesëmarrës kishte përmendur digjitalizimin e administratës publike si mënyrë për të zgjidhur korrupsionin, në mënyrë që aplikimet për punësim dhe tenderë të bëhen sa më transparente.

Në përgjithësi, nga fokus grupet është vërejtur një hezitim apo frikë e pjesëmarrësve për t'u ankuar në rast se shohin apo hasin ndonjë veprim korruptiv. Në Prishtinë, pjesëmarrësit theksuan se nuk ishin të interesuar të raportojnë korrupsionin, dhe kjo mund të jetë për shkak të besimit të ulët të pjesëmarrësve në institucionet e drejtësisë. Në Prizren, pjesëmarrësit përmendën frikën si arsye për të mos raportuar rastet. Një pjesëmarrës theksoi se nëse bën ankesë për punësim në baza familjare, mund të humbësh përfundimisht mundësinë për t'u punësuar në të ardhmen. Ngjajshëm, një pjesëmarrës në Ferizaj theksoi se njerëz të fuqishëm janë prapa proceseve korruptive dhe denoncimi i rasteve ku ata janë të përfshirë mund të ketë pasoja për denoncuesin.

Në të gjitha fokus grupet në përgjithësi, pjesëmarrësit ishin të mendimit që mediat kanë ndikim shumë të rëndësishëm në formimin e perceptimit publik, dhe se ato kanë ndikim të rëndësishëm edhe në Kosovë lidhur me korrupsionin. Në disa fokus grupe (Prishtinë, Ferizaj, Pejë), pjesëmarrësit përmendën përgjimet e publikuara, të cilës iu referoheshin si "afëra pronto", që kanë ngritur perceptimin e publikut për korrupsion në Kosovë, pasi që përgjimet kanë shfaqur angazhimin e zyrtarëve të lartë publik në afëra korruptive dhe punësime familjare.

IV. KONKLUZIONET

Përfundimisht, përmes të tri metodave të hulumtimit përfshirë anketave, intervistave dhe fokus grupeve, është gjetur se qytetarët besojnë se ka korrupsion të nivelit të lartë në institucionet publike në Kosovë. Rezultatet e anketave treguan se për 12 institucioneve publike (duke mos përfshirë Ministritë) ekziston një perceptim që kanë korrupsion të nivelit të lartë (mbi 50%), që gjeti mbështetje në intervista dhe fokus grupe, ku pjesëmarrësit theksuan se korrupsioni është i përhapur dhe funksionon si zingjir në të gjitha institucionet e shtetit.

Të intervistuarit vërejtën se rezultatet e anketës tregojnë një diskrepancë të konsiderueshme në mes perceptimit të të anketuarve për korrupsion, dhe përqindjes së atyre të cilët kanë pasur përvoja personale me korrupsion (13%). Në njëërën anë, disa pjesëmarrës në intervista dyshuan se perceptimi i publikut për korrupsion është real, pasi që njohuritë e qytetarëve për korrupsion janë të bazuara në informatat që ata i marrin nga mediat - për të cilat kishte një pajtim të përgjithshëm se luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e opinionit publik. Në anën tjetër, mendimi i shumicës së pjesëmarrësve në fokus grupe dhe intervista, ishte se korrupsioni në Kosovë nuk është vetëm perceptim, por një realitet i normalizuar me të cilin qytetarët përballen çdo ditë.

Rezultatet e anketës renditën Ministritë, Kryeministrinë, dhe Partitë Politike në krye të listës së institucioneve për të cilat besojnë se kanë nivel të lartë të korrupsionit. Në anën tjetër, nga diskutimi me pjesëmarrësit në intervista dhe fokus grupe, gjetja kryesore ishte se institucionet e shëndetësisë dhe institucionet arsimore janë në krye të institucioneve më të korruptuara. Ishte shumë e zakonshme që pjesëmarrësit të përmendin raste të korrupsionit në spitale dhe klinika lokale. Gjithashtu, pjesëmarrësit në disa fokus grupe theksuan se ka korrupsion edhe në sektorin e organizatave jo-qeveritare, mirëpo kjo ishte vetëm deri diku e mbështetur nga rezultatet e anketave, dhe pothuajse aspak e mbështetur nga intervistat.

Rezultatet e anketimit tregojnë se vetëm 35% e respondentëve e shohin mos-efikasitetin e sistemit gjyqësor si shkak të korrupsionit në Kosovë, që ishte ndryshe nga gjetjet në intervista dhe fokus grupe, ku pjesëmarrësit vendosën theks të veçantë në prokurori dhe gjykata. Edhe pse ishte vërejtur një humbje e besimit të pjesëmarrësve në prokurori dhe gjykata për të luftuar korrupsionin, ata rekomanduan që zgjidhja më e natyrshme e problemit të korrupsionit në Kosovë do të ishte nëse këto institucione bëjnë ndjekjen, gjykimin dhe penalizimin e zyrtarëve që kanë kryer vepra të korrupsionit në mënyrë efektive dhe me kohë.

Disa të intervistuar kishin deklaruar se nganjëherë edhe qytetarët mund të konsiderohen fajtor për korrupsionin e lartë në Kosovë, për shkak që ata janë në gatishmëri që, sidomos në raste të urgjencës, të paguajnë apo ofrojnë ryshfete zyrtarëve publik edhe nëse nuk iu është

kërkuar një gjë e tillë. Nuk kishte ndonjë referencë të tillë në rezultatet e anketimit apo në fokus grupe.

Edhe pse shumica e të anketuarve për shumë dimensione të sjelljeve korruptive thonë që janë plotësisht të papranueshme, nga fokus grupet dhe intervistat është gjetur se tolerimi i korrupsionit është më i lartë. Këtu duhet të theksohet se disa nga pjesëmarrësit, nga ata që kanë parë, thonë që tanimë nuk mund të flasim për tolerimin e korrupsionit por për normalizimin e tij si fenomen, sidomos në institucionet shëndetësore.



www.levizjafol.org | info@levizjafol.org
Rr. Andrea Gropa No. 35 10000 Prishtinë - Kosovë